



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër
12- Zyrtarisht /2024
Deçan, 12.07.2024

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit
Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Muslijaj

Nga: UD Shefi i Drejtorisë Z. Muhamet Avdijaj

Lënda: Raport Pune për periudhën 04 Janar 2024 – 12 Korrik 2024, i
Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e
Deçanit.

	Dr. Gj. kaster 24410
	02 29.07.24



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Raportin e punës për periudhë 04 .01. 2024 – 12.07.2024 për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan.

R A P O R T P U N E

Për periudhën 04.01. 2024– 12.07.2024 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan

1. Shefi i Sherbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentin e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2024 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **350** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar **310** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve iu është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **40** kërkesa janë në procedurë e sipër. I njëjti ka lëshuar **245** aktvendime për azhurimin e lëndëve të terrenit.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhurno duke i fut të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-es

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoro juridike si dhe së bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .



2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **267** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesë së palëve siç janë : Ndarja e parcelave, Bashkimi i parcelave, Regjistrimi i Objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etje. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **10** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër.

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **8** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **249** kopje plani.

3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsejtë **876** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK. Gjithsejt lëndë të kryera nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster deri në përpilimin e këtij raporti janë **1710** lëndë të ndryshme.

Kjo Drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

Raportin e përpiloi :
UD Shefi i kësaj Drejtorie
Muhamet Avdijaj



Drejtori
Agron Muslijaj

